

NEWSLETTER CONNECT ALBANIA PROGRAM

2021

No. 12

CONNECT
ALBANIA

Zyra e Connect Albania

Shënim për lexuesin: Connect Albania vazhdon të rritet në angazhimin e komunitetit shqiptar jashtë vendit. Tani kemi 14 Agjentë Zhvillimi të certifikuar, të cilët janë një urë lidhëse midis vendeve të destinacioneve dhe vendit të origjinës për të lehtësuar investimet e huaja në Shqipëri. Ky numër i buletinit informativ i dedikohet Zj. Zharina Sinani. Lista e plotë e të gjithë Agjentëve të Zhvillimit gjendet online në linkun: <https://www.adbc.al/regjistri-publik-i-agjenteve-te-zhvillimit-te-inate-resuar/>

E lindur në Tepelene, në Shqipërinë jugore në vitin 1973, Zharina Sinani është zhvendosur fillimisht në Tiranë në moshën 6 vjeçare ku dhe u shkollua duke përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik. Më tej si pasojë e ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe politike, Znj. Sinani emigroi në Itali ku gjatë vitit 1997 u zhvendos në Livorno dhe dy vjet më vonë në Arezzo në Toscana, ku jeton edhe sot.

Përgjatë karrierës së saj profesionale, Zharina ka punuar si ndërmjetës gjuhësor-kulturor për dhjetë vjet me organizatën ndërkombëtare Oxfam Italia dhe më tej ka marrë pjesë në projekte të tjera me organizata të tjera. Falë angazhimit dhe trajnimit të saj, është përfshirë në sektorë dhe vende të ndryshme që kanë të bëjnë me diasporën si qendrat e punësimit, prefektura, qendrat e integritimit, spitalet dhe shkollat, zyrat komunale dhe qendrat e ndihmës sociale. Gjithashtu i është dhënë mundësia të kryej dëshmi Kulturore, duke paraqitur Shqipërinë në të gjitha aspektet, gjeografike, ekonomike, kulturore dhe sociale të saj.

Aktualisht Zharina kryen punë vullnetare krahas ndjekjes së punës në kantinën që ajo dhe familja e saj zotërojnë. Për Zharininë, të jesh një sipërmarrës dhe të merresh me problemet e një aktiviteti ekonomik, i japin një kuptueshmëri më të mirë mbi dinamikën e lidhur me zhvillimin e biznesit.

Falë integritit të mirë në mjedisin shoqëror, njohjes së strukturës ekonomike dhe produktive të zonës si dhe realitetin e të dy kombeve dhe familjarizimit me projektin Connect Albania, Znj. Zharina disponon gjithë aftësitë dhe informacionin e nevojshëm për të asistuar të interesuarit që dëshirojnë të regjistrojnë biznes në Shqipëri dhe të kryejnë aktivitet ekonomik në sektorë të ndryshëm.



Disa nga pasionet e saj si fotografia, arti dhe shkrimi gjithashtu i kanë dhënë mundësinë për të njohur botën e botimeve italo-shqiptare në ekspozita të ndryshme midis Torinos dhe Tiranës, ku gjithashtu ka marrë pjesë në një kurs të ekspozitës së artit në Firenze, me perspektivën për të qenë në gjendje të kontribuojë në zhvillimin dhe promovimin e Shqipërisë në aspektet e saj më karakteristike.



Mekanizmi Connect Albania është një pjesë e rëndësishme e programit "Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë". Ai synon të kontribuojë në rritjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Programi zbatohet nga Zyra në Shqipëri e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) – Agjencia e Migrimit e OKB-së, me financimin e Ministrisë Italiane për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe ministrinë e tjera të linjës, si edhe Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS).

